

DËFTESË E SIGURISË TEKNIKE



SP4099 MS Clear Coat 2:1

SEKSIONI 1: Identifikim i lëndës/përgatesës dhe i kompanisë/ndërmarrjes

1.1 Identifikuesi i produktit

Emri i produktit : SP4099 MS Clear Coat 2:1
Tipi i produktit : Lëng.

1.2 Përdorime përkatëse të identifikuara të lëndës ose të përzierjes dhe përdorime që nuk këshillohen

Përdorime të identifikuara

Use in coatings Clearcoat

1.3 Hollësi për ofruesin e dëftesës së sigurisë teknike

Valspar b.v.
Zuiveringweg 89
8243 PE Lelystad
The Netherlands
tel: +31 (0)320 292200
fax: +31 (0)320 292201

valspar

Adresa e emailit të personit përgjegjës për këtë SDS (Dëftesë e Sigurisë Teknike) : msds@valspar.com

Kontakti shtetëror

GPS Automotive Lelystad
tel: +31 (0)320 292288
fax: +31 (0)320 292201

1.4 Numri i telefonit për urgjenca

Enti këshillimor shtetëror/Qendra e Helmimeve

Numri i telefonit : TELEFONONI NË: +1 703-741-5970 (Orari i shërbimit - 24 orë)

Furnizuesi

Numri i telefonit : TELEFONONI NË: +31 (0)320 292200 (8:30AM - 5PM)

SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive

2.1 Klasifikimi i lëndës ose i përzierjes

Përkufizimi i produktit : Përzierje

Klasifikimi sipas Rregullores (EC) Nr. 1272/2008 [CLP/GHS]

Flam. Liq. 3, H226
Skin Irrit. 2, H315
Eye Irrit. 2, H319
Skin Sens. 1, H317
STOT SE 3, H335
STOT SE 3, H336
STOT RE 2, H373
Asp. Tox. 1, H304
Aquatic Chronic 3, H412

Produkti klasifikohet si i rrezikshëm, sipas Rregullores (EC) 1272/2008 të amenduar.

Klasifikimi sipas Direktivës 1999/45/EC [DPD]

Produkti klasifikohet si i rrezikshëm sipas Direktivës 1999/45/EC dhe amendamenteve të saj.

SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive

- Klasifikimi** : R10
Xn; R20/21, R65
R66
R52/53
- Rrezikshmëri fizike/kimike** : I ndezshëm.
- Rrezikshmëri për shëndetin e njeriut** : I dëmshëm po të frymëthitet dhe në kontakt me lëkurën. I dëmshëm: rrezikon të shkaktojë dëmtim të mushkërive po të gëlltitet. Ekspozimi i përsëritur mund të shkaktojë tharje ose plasaritje të lëkurës.
- Rrezikshmëri mjedisore** : I dëmshëm për gjallesat ujore, mund të shkaktojë efekte të padëshirueshme afatgjatë në mjedisin ujor.

Shih Seksionin 16 për tekstin e plotë të frazave R ose të deklaratave H të parashtruara më lart.

Shihni seksionin 11 për të dhëna më të hollësishme lidhur me pasojat dhe simptomat shëndetësore.

2.2 Elemente të etiketës

Piktograme të rrezikshmërisë :



Fjalë sinjalizuese :

Rrezik

Njoftime të rrezikshmërisë :

Lëng dhe avull të ndezshëm.
Shkakton irrim serioz të syve.
Shkakton irrim të lëkurës.
Mund të shkaktojë një reaksion alergjik të lëkurës.
Mund të jetë vdekjeprurëse po të gëlltitet dhe të depërtojë në rrugët e frymëmarrjes.
Mund të shkaktojë irrim të rrugëve të frymëmarrjes.
Mund të shkaktojë përgjumje ose marramendje.
Mund të shkaktojë dëmtime të organeve në rast ekspozimi të zgjatur ose të përsëritur.
E dëmshme për gjallesat ujore me efekte afatgjata.

Njoftime paralajmëruese

Parandalim :

Përdorni doreza mbrojtëse. Përdorni mbrojtje për sytë ose fytyrën. Mbajeni larg nxehtësisë, sipërfaqeve të nxehta, shkëndijave, flakëve të gjalla dhe burimeve të tjera flakëmarrëse. Ndalohet duhani. Përdorni pajisje elektrike, ajruese ose ndriçuese dhe trajtuese materialesh të përshtatshme për mjedis me rrezik shpërthimi. Shmangni çlirimin në mjedis. Mos frymëthithni avujt ose spërklata.

Përgjigje :

PO TË FRYMËTHITHET: Nxirreni personin në ajër të freskët dhe ndihmoni që të marrë frymë pa pengesa. PO TË GËLLTITET: Merrni në telefon një QENDËR HELMIMI ose një mjek. MOS provokoni të vjellë. PO TË PREKË LËKURËN (ose flokët): Hiqni menjëherë të gjitha rrobat e ndotura. Shpëlajeni lëkurën me ujë ose bëni dush.

Ruajtja :

Mbajeni të freskët.

Heqja/Asgjësimi :

Eliminoni përmbajtjen dhe enën në pajtim me të gjitha rregulloret lokale, rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ingredientë të rrezikshëm :

n-butyl acetate
xylene
Solvent naphtha (petroleum), light arom.
Solvent naphtha (petroleum), light arom.
Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate I
Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate II
bis(1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl) sebacate
methyl 1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl sebacate

Elemente suplementare të etiketës :

Nuk zbatohet.

SEKSIONI 2: Identifikimi i rrezikshmërive

Aneksi XVII – Kufizime në prodhimin, hedhjen në treg dhe përdorimin e disa lëndëve, përzierjeve dhe artikujve të rrezikshëm

Kërkesa të posaçme për paketimin

Enët duhen pajisur me kapëse rezistente ndaj fëmijëve : Nuk zbatohet.

Paralajmërim i prekshëm i rrezikut : Nuk zbatohet.

2.3 Rrezikshmëri të tjera

Rrezikshmëri të tjera që nuk figurojnë në klasifikim : Asnjë nuk dihet.

SEKSIONI 3: Përbërja/të dhëna për ingredientët

3.2 Përzierje : Përzierje

| Emri i produktit/ ingredientit | Identifikuesit | w% | Klasifikimi | | Lloji |
|---|--|-----------|--|--|---------|
| | | | 67/548/EEC | Rregullorja (EC) Nr. 1272/2008 [CLP] | |
| n-butyl acetate | REACH #: 01-2119485493-29 EC: 204-658-1 CAS: 123-86-4 Indeksi: 607-025-00-1 | ≥25 - ≤50 | R10 R66, R67 | Flam. Liq. 3, H226 STOT SE 3, H336 EUH066 | [1] |
| xylene | REACH #: 01-2119488216-32 EC: 215-535-7 CAS: 1330-20-7 Indeksi: 601-022-00-9 | ≥10 - ≤25 | R10 Xn; R20/21 Xi; R38 | Flam. Liq. 3, H226 Acute Tox. 4, H312 Acute Tox. 4, H332 Skin Irrit. 2, H315 Eye Irrit. 2, H319 STOT SE 3, H335 STOT RE 2, H373 Asp. Tox. 1, H304 | [1] [2] |
| Solvent naphtha (petroleum), light arom. | REACH #: 01-2119455851-35 EC: 265-199-0 CAS: 64742-95-6 | ≤10 | R10 Xn; R65 Xi; R37 R66, R67 N; R51/53 | Flam. Liq. 3, H226 STOT SE 3, H335 STOT SE 3, H336 Asp. Tox. 1, H304 Aquatic Chronic 2, H411 EUH066 | [1] |
| 2-methoxy- 1-methylethyl acetate | REACH #: 01-2119475791-29 EC: 203-603-9 CAS: 108-65-6 Indeksi: 607-195-00-7 | ≤5 | R10 | Flam. Liq. 3, H226 | [2] |
| ethylbenzene | REACH #: 01-2119489370-35 EC: 202-849-4 CAS: 100-41-4 Indeksi: 601-023-00-4 | ≤5 | F; R11 Xn; R20, R48/20, R65 | Flam. Liq. 2, H225 Acute Tox. 4, H332 STOT RE 2, H373 (organe dëgjimi) Asp. Tox. 1, H304 Aquatic Chronic 3, H412 | [1] [2] |
| Solvent naphtha (petroleum), light arom. | REACH #: 01-2119455851-35 EC: 265-199-0 | ≤3 | R10 Xn; R65 Xi; R37 | Flam. Liq. 3, H226 STOT SE 3, H335 STOT SE 3, H336 | [1] |

SEKSIONI 3: Përbërja/të dhëna për ingredientët

| | | | | | |
|---|--|------|--|---|---------|
| 1,2,4-trimethylbenzene | CAS: 64742-95-6 REACH #: 01-2119472135-42 EC: 202-436-9 CAS: 95-63-6 Indeksi: 601-043-00-3 | ≤3 | R66, R67 N; R51/53 R10 Xn; R20 Xi; R36/37/38 N; R51/53 | Asp. Tox. 1, H304 Aquatic Chronic 2, H411 EUH066 Flam. Liq. 3, H226 Acute Tox. 4, H332 Skin Irrit. 2, H315 Eye Irrit. 2, H319 STOT SE 3, H335 Aquatic Chronic 2, H411 | [1] [2] |
| Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate I | REACH #: 01-0000015075-76 CAS: 104810-48-2 | ≤0.3 | R43 N; R51/53 | Skin Sens. 1A, H317 Aquatic Chronic 2, H411 | [1] |
| Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate II | REACH #: 01-0000015075-76 CAS: 104810-47-1 | ≤0.3 | R43 N; R51/53 | Skin Sens. 1A, H317 Aquatic Chronic 2, H411 | [1] |
| bis(1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl) sebacate | REACH #: 01-2119537297-32 EC: 255-437-1 CAS: 41556-26-7 | ≤0.3 | R43 N; R50/53 Shihni seksionin 16 për tekstin e plotë të R-frazave të përmendura më lart. | Skin Sens. 1A, H317 Aquatic Acute 1, H400 (M=1) Aquatic Chronic 1, H410 (M=1) Shih Seksionin 16 për tekstin e plotë të deklaratave H të parashtruara më lart. | [1] |

Nuk ka të pranishëm përbërës të tjerë që, me sa është në dijeni furnizuesi dhe në përqendrimet e zbatueshme, klasifikohen si të rrezikshëm për shëndetin ose mjedisin, janë PBT-të apo vPvB-të, ose Substanca njëlloj shqetësuese apo të cilave u është bashkëlidhur një kufi ekspozimi në vendin e punës dhe prandaj duhen raportuar në këtë seksion.

Lloji

[1] Lëndë e klasifikuar me një rrezik për shëndetin apo për mjedisin

[2] Lëndë me një kufi ekspozimi në vendin e punës

[3] Lënda i kënaq kriteret për PBT sipas Rregullores (EC) Nr. 1907/2006, Aneksi XIII

[4] Lënda i kënaq kriteret për vPvB sipas Rregullores (EC) Nr. 1907/2006, Aneksi XIII

[5] Lëndë njëlloj shqetësuese

Kufijtë e ekspozimit në vendin e punës, nëse ekzistojnë, gjenden të renditur në seksionin 8.

SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë

4.1 Përshkrim i masave të ndihmës së shpejtë

- Të përgjithshme** : Në çdo rast dyshimi ose kur simptomat nuk largohen, kërkoni ndihmë mjekësore. Kurrë mos i jepni ndonjë gjë nga goja një personi pa ndjenja. Nëse viktimi është pa ndjenja, vendoseni në pozicion sigurie (të shtrirë e të kthyer në krah) dhe kërkoni ndihmë mjekësore.
- Kontakt me sytë** : Remove contact lenses, irrigate copiously with clean, fresh water, holding the eyelids apart for at least 10 minutes and seek immediate medical advice.
- Frymëthithje** : Nxirrni në ajër të pastër. Mbajeni personin ngrohtë dhe në prehje. Nëse viktimi nuk po merr frymë, nëse frymëmarrja është e parregullt ose nëse ka ndodhur pushim i frymëmarrjes, i duhet dhënë frymëmarrje artificiale ose oksigjen nga personel i trajnuar.
- Kontakti me lëkurën** : Hiqni rrobat dhe këpucët e ndotura. Lajeni mirë lëkurën me ujë dhe sapun, ose përdorni një pastrues lëkure të miratuar. Mos përdorni tretës ose hollues.
- Gëlltitje** : Në rast gëlltitjeje, këshillohuni menjëherë me mjekun, duke ia treguar këtë enë ose etiketë. Mbajeni personin ngrohtë dhe në prehje. MOS provokoni të vjellë.

SEKSIONI 4: Masa të ndihmës së parë

Mbrojtje për personat që japin ndihmën e shpejtë : Nuk duhet ndërmarrë asnjë veprim që shoqërohet me rrezikim të personit ose pa trajnim të përshtatshëm. Nëse dyshohet se ka ende tymra, forcat e shpëtimit duhet të përdorin maska të përshtatshme ose aparat frymëmarrjeje autonom. Mund të jetë e rrezikshme për ofruesin e ndihmës të japë frymëmarrje gojë-më-gojë. Lajini mirë me ujë rrobat e ndotura para se t'i hiqni, ose përdorni doreza.

4.2 Simptomat dhe efektet më të rëndësishme, akute dhe të vonuara

Nuk ka të dhëna të përdorshme për përzierjen vetë. The mixture has been assessed following the conventional method of the CLP Regulation (EC) No 1272/2008 and is classified for toxicological properties accordingly. Shihni Seksionet 2 dhe 3 për hollësi të mëtejshme.

Ekspozimi ndaj përqendrimeve të avujve të tretësve mbi kufijtë e përcaktuar të ekspozimit në vendin e punës mund të japë efekte shëndetësore të padëshiruara, të tilla si iritimi të membranave mukoze dhe të rrugëve të frymëmarrjes dhe efekte të padëshiruara në veshka, mëlçi dhe sistemin nervor qendror. Ndër shenjat dhe simptomat duhen përmendur dhimbje koke, marrje mendsh, kapitje, dobësi muskulare, përgjumje dhe, në raste të skajshme, humbje e ndjenjave.

Tretësit mund t'i shkaktojnë disa prej efekteve të mësipërme duke u përthithur nëpërmjet lëkurës. Kontakti i përsëritur ose i zgjatur me përzierjen mund të shkaktojë largimin e yndyrës natyrore nga lëkura, duke çuar në dermatit kontakti jo-alergjik dhe përthithje nëpërmjet lëkurës.

Po të spërkatet në sy, lëngu mund të shkaktojë iritimi dhe dëmtim të kthyeshem.

Gëlltitja mund të shkaktojë të përziera, diarre dhe të vjella.

Kjo merr parasysh, atje ku njihen, efektet e vonuara dhe të menjëhershme si dhe efektet kronike të përbërësve nga ekspozimi afatshkurtër dhe afatgjatë nëpërmjet rrugëve gojore, frymëthithëse dhe dermale të ekspozimit dhe kontaktit me sytë.

Përmban Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate I, Hydroxyphenyl-benzotriazole derivate II, bis(1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl) sebacate, methyl 1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl sebacate. Mund të shkaktojë një reaksion alergjik.

4.3 Indikim për kujdesin dhe trajtimin mjekësor të menjëhershëm dhe trajtimin e posaçëm që mund të duhet

Shënime për mjekun : Trajtoni në mënyrë simptomatike. Nëse janë gëlltitur ose frymëthithur sasi të mëdha, lidhuni menjëherë me një specialist për trajtimin e helmimeve.

Trajtime specifike : Nuk ka trajtim specifik.

Shihni të dhënat toksikologjike (seksioni 11)

SEKSIONI 5: Masa të luftës kundër zjarrit

5.1 Mjete zjarrfikëse

Mjete fikëse të përshtatshme : Rekomandohet: shkumë rezistente ndaj alkoolit, CO₂, pluhura, spërkatje me ujë.

Mjete fikëse të papërshtatshme : Mos përdorni rrymë uji.

5.2 Rrezikshmëri të posaçme nga lënda ose përzierja

Rrezikshmëritë nga lënda ose përzierja : Zjarri do të prodhojë tym të zi të dendur. Ekspozimi ndaj produkteve të shpërbërjes mund të jetë me rrezikshmëri për shëndetin.

Produkte të rrezikshme të shpërbërjes termike : Produktet e shpërbërjes mund të përfshijnë materialet e mëposhtme: monoksid karboni, dyoksid karboni, tym, okside azoti.

5.3 Këshilla për zjarrfikësit

Veprime mbrojtëse të posaçme për zjarrfikësit : Ftohini me ujë enët që i janë ekspozuar zjarrit. Mos lejoni rrjedhje nga vendi ku ka rënë zjarr drejt kanalizimeve shkarkuese ose vijave ujore.

Pajisje mbrojtëse e posaçme për zjarrfikësit : Mund të jetë e nevojshme të përdoret aparat frymëmarrës i përshtatshëm.

SEKSIONI 6: Masa në rast çlirimi aksidental

6.1 Paralajmërimi personale, pajisje mbrojtëse dhe procedura të urgjencës

- Për personel jo të ndërhyrjes urgjente** : Mënjaroni burimet ndezëse dhe ajrojeni zonën. Mos frymëthithni avullin ose mjegullimin. Referojuni masave mbrojtëse të përmendura në seksionet 7 dhe 8.
- Për shërbimet e ndërhyrjes urgjente** : Në qoftë se kërkohet veshje e specializuar për të trajtuar derdhjen, merrni parasysh çdo informacion në Seksionin 8 për materialet e përshtatshme dhe të papërshtatshme. Shihni edhe informacionin në "Për personel jo të ndërhyrjes urgjente".

6.2 Masa paraprake për mjedisin

- : Mos lejoni të hyjë në kanale shkarkimi ose vija uji. Në rast se produkti shkakton ndotje të liqeneve, lumenjve ose kanaleve të ujërave të zeza, njoftoni autoritetet përkatëse në pajtim me rregulloret vendore.

6.3 Metoda dhe materiale për kontroll dhe pastrim

- : Izolujini dhe grumbullojini derdhjet e vogla me material përthithës të padjegshëm, të tillë si rërë, dhé, vermikulit ose miell fosil, pastaj mblidheni materialin në një enë për heqje/eliminim në pajtim me rregulloret vendore (shihni Seksionin 13). Mundësisht pastroni me një detergjent. Mos përdorni tretës.

6.4 Referencë në seksione të tjera

- : Shihni Seksionin 1 për informacion të kontaktit në rast urgjence.
Shihni Seksionin 8 për informacion në lidhje me pajisjet e përshtatshme të mbrojtjes personale.
Shihni Seksionin 13 për informacion të mëtejshëm rreth trajtimit të mbetjeve.

SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja

Informacioni në këtë seksion përmban këshilla dhe udhëzime të përgjithshme. Për çdo informacion specifik ndaj një përdorimi që ofrohet në Skenarin/et e Ekspozimit, duhet këshilluar Lista e Përdorimeve të Identifikuara në Seksionin 1.

7.1 Masa paraprake për trajtim të sigurtë

- : Mos lejoni krijimin e përqendrimeve të ndezshme ose shpërthyesë të avujve në ajër, si dhe të përqendrimeve të avujve më të larta se kufijtë e ekspozimit në vendin e punës.
- Veç kësaj, produkti duhet përdorur vetëm në zona ku nuk ka drita të pambrojtura ose burime të tjera ndezëse. Pajisjet elektrike duhen mbrojtur sipas normave të përshtatshme.
- Përzierja mund të ngarkohet elektrostatisht: përdorni gjithnjë kablllo tokëzimi kur po transferoni nga një enë në tjetrën.
- Punëtorët duhet të veshin këpucë dhe rroba antistatike, ndërsa dyshemetë duhet të jenë të tipit përcjellës.
- Mbajeni larg nxehtësisë, shkëndijave dhe flakës. Mos përdorni vegla që prodhojnë shkëndija.
- Shmangni kontaktin me lëkurën dhe sytë. Shmangni frymëthithjen e pluhurit, partikulateve, spërkatjes ose mjegullimit që çlirohen nga aplikimi i kësaj përzierjeje. Mos e thithni pluhurin e prodhuar gjatë zmerilimit.
- Në zonën ku trajtohet, ruhet dhe përpunohet ky material, nuk duhet lejuar ngrënia, pirja dhe duhani.
- Vishni pajisje të përshtatshme për mbrojtje personale (shihni seksionin 8). Kurrë mos përdorni trysninë për ta zbratur. Ena nuk e përballon trysninë. Gjithnjë ruajeni në enë prej materiali të njëjtë me enën origjinale. Respektoni ligjet e shëndetit dhe të sigurisë në vendin e punës.
- Mos lejoni të hyjë në kanale shkarkimi ose vija uji.
- Të dhëna për mbrojtjen kundër zjarrit dhe shpërthimit**
- Avujt janë më të rëndë se ajër dhe mund të përhapen në dysheme. Avujt mund të formojnë përzierje shpërthyesë me ajrin.

Kur punëtorëve, qoftë duke spërkatur ose jo, u duhet të punojnë në kabinën e spërkatjes, vetëm ajrimi vështirë se mund të mjaftojë për të kontrolluar partikulatet dhe avujt e tretësve në të gjitha rastet. Në këto rrethana, punëtorët duhet të përdorin një aparat respirator të ushqyer me ajër të komprimuar gjatë spërkatjes dhe më pas derisa përqendrimet e partikulateve dhe avujve të tretjes të kenë rënë nën kufijtë e ekspozimit.

SEKSIONI 7: Trajtimi dhe ruajtja

7.2 Kushtet për ruajtje të sigurt, duke përfshirë edhe papajtueshmëritë e mundshme

Ruajeni sipas rregulloreve vendore.

Shënime për magazinimin së bashku

Mbajeni larg: agjentë oksidues, alkale të forta, acide të forta.

Të dhëna të mëtejshme për kushtet e magazinimit

Ndiqni udhëzimet në etiketë. Ruajeni në një vend të thatë, të freskët dhe të ajruar mirë. Mbajeni larg nxehtësisë dhe dritës diellore të drejtpërdrejtë. Mbajeni larg burimeve ndezëse. Ndalohet duhani. Mos lejoni hyrje të paautorizuara. Enët që janë hapur duhet të mbyllën përsëri hermetikisht me kujdes dhe të mbahen në pozicion vertikal për të parandaluar rrjedhjet.

7.3 Përdorim(e) përfundimtar(e) i(të) posaçëm(me)

Rekomandime : Nuk zotërohet.

Zgjidhje specifike për sektorët industrialë : Nuk zotërohet.

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

Për çdo informacion specifik ndaj një përdorimi që ofrohet në Skenarin/et e Ekspozimit, duhet këshilluar Lista e Përdorimeve të Identifikuara në Seksionin 1.

8.1 Parametra të kontrollit

Kufij të ekspozimit në vendin e punës

| Emri i produktit/ingredientit | Vlera të kufirit të ekspozimit |
|---------------------------------|---|
| xylene | EU OEL (Evropë, 12/2009). Përthithet nga lëkura. Shënime: list of indicative occupational exposure limit values STEL: 442 mg/m ³ , 0 herë për turn, 15 minuta. STEL: 100 ppm, 0 herë për turn, 15 minuta. TWA: 221 mg/m ³ , 0 herë për turn, 8 orë. TWA: 50 ppm, 0 herë për turn, 8 orë. |
| 2-methoxy-1-methylethyl acetate | EU OEL (Evropë, 12/2009). Përthithet nga lëkura. Shënime: list of indicative occupational exposure limit values TWA: 50 ppm 8 orë. TWA: 275 mg/m ³ 8 orë. STEL: 100 ppm 15 minuta. STEL: 550 mg/m ³ 15 minuta. |
| ethylbenzene | EU OEL (Evropë, 12/2009). Përthithet nga lëkura. Shënime: list of indicative occupational exposure limit values STEL: 884 mg/m ³ 15 minuta. STEL: 200 ppm 15 minuta. TWA: 442 mg/m ³ 8 orë. TWA: 100 ppm 8 orë. |
| 1,2,4-trimethylbenzene | 80/1107/EEC (Evropë). CEIL: 20 ppm CEIL: 100 mg/m ³ EU OEL (Evropë, 12/2009). Shënime: list of indicative occupational exposure limit values TWA: 100 mg/m ³ 8 orë. TWA: 20 ppm 8 orë. |

Procedura monitorizimi të këshilluara : Nëse ky produkt përmban ingredientë me kufij ekspozimi, mund të jetë i nevojshëm monitorizim personal, i vendit të punës, atmosferik ose biologjik për të përcaktuar efektshmërinë e ajrimit ose masave të tjera të kontrollit dhe/ose nevojën për të përdorur pajisje mbrojtëse të rrugëve të frymëmarrjes. U duhet referuar standardeve të monitorimit, të tilla si: Standardi European EN 689 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për vlerësimin e ekspozimit me frymëthithje ndaj agjentëve kimikë për krahasim me vlerat limit dhe strategjinë e matjeve) Standardi European EN 14042 (Ajri në vendin e punës – Udhëzime për zbatimin dhe përdorimin e

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

procedurave për vlerësimin e ekspozimit ndaj agjentëve kimikë dhe biologjikë) Standardi European EN 482 (Ajri në vendin e punës – Kërkesa të përgjithshme për ekzekutimin e procedurave për matjen e agjentëve kimikë) Do të jetë i nevojshëm edhe referimi ndaj dokumenteve udhëzuese në rang shtetëror për metodat e përcaktimit të lëndëve me rrezikshmëri.

DNEL/DMEL

| Emri i produktit/ingredientit | Lloji | Ekspozimi | Vlera | Popullata | Efektet |
|--|-------|---------------------|------------------------|--------------|----------|
| n-butyl acetate | DNEL | Afatgjatë | 300 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 600 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë | 300 mg/m ³ | Punëtorët | Lokal |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 600 mg/m ³ | Punëtorët | Lokal |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 11 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatshkurtër Dermal | 11 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë | 35.7 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 300 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë | 35.7 mg/m ³ | Konsumatorët | Lokal |
| xylene | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 289 mg/m ³ | Punëtorët | Lokal |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 289 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë | 221 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 180 mg/kg | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatshkurtër | 174 mg/m ³ | Konsumatorët | Lokal |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatshkurtër | 174 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë | 14.8 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 108 mg/kg | Konsumatorët | Sistemik |
| Solvent naphtha (petroleum), light arom. | DNEL | Afatgjatë Gojor | 1.6 mg/kg | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë | 32 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 11 mg/kg | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Gojor | 11 mg/kg | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 25 mg/kg | Punëtorët | Sistemik |
| 2-methoxy-1-methylethyl acetate | DNEL | Afatgjatë | 150 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 153.5 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë | 275 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Frymëthithje | | | |

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

| | | | | | |
|---|------|-----------------------|------------------------|--------------|----------|
| ethylbenzene | DNEL | Afatgjatë Dermal | 54.8 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 33 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Gojor | 1.67 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 77 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 180 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 15 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| Solvent naphtha (petroleum), light arom. | DNEL | Afatgjatë Gojor | 1.6 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 25 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 150 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 11 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| bis(1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl) sebacate | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 32 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Gojor | 11 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 11 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 3.53 mg/m ³ | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 2 mg/kg bw/ditë | Punëtorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Frymëthihje | 0.87 mg/m ³ | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Dermal | 1 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |
| | DNEL | Afatgjatë Gojor | 0.5 mg/kg bw/ditë | Konsumatorët | Sistemik |

PNEC

| Emri i produktit/ingredientit | Hollësi për Mjedisin Përkatës | Vlera | Hollësi për Metodën |
|---------------------------------|--|--------------|---------------------|
| n-butyl acetate | Ujë i ëmbël | 0.18 mg/l | - |
| | Detare | 0.018 mg/l | - |
| | Sediment uji të ëmbël | 0.981 mg/kg | - |
| | Sediment uji të kripur | 0.0981 mg/kg | - |
| | Dhé | 0.0903 mg/kg | - |
| | Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza | 35.6 mg/l | - |
| xylene | Ujë i ëmbël | 0.327 mg/l | - |
| | Ujë deti | 0.327 mg/l | - |
| | Sediment uji të ëmbël | 12.46 mg/kg | - |
| | Sediment uji të kripur | 12.46 mg/kg | - |
| | Dhé | 2.31 mg/kg | - |
| | Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza | 6.58 mg/l | - |
| 2-methoxy-1-methylethyl acetate | Ujë i ëmbël | 0.635 mg/l | - |
| | Detare | 0.0635 mg/l | - |
| | Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza | 100 mg/l | - |
| | Sediment uji të ëmbël | 3.29 mg/kg | - |
| | Sediment uji të kripur | 0.329 mg/kg | - |
| | Dhé | 0.29 mg/kg | - |
| ethylbenzene | Ujë i ëmbël | 0.1 mg/l | - |
| | Ujë deti | 0.01 mg/l | - |

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

| | | | |
|---|--|--------------|---|
| bis(1,2,2,6,6-pentamethyl-4-piperidyl) sebacate | Sediment uji të ëmbël | 13.7 mg/kg | - |
| | Sediment uji të kripur | 1.37 mg/kg | - |
| | Dhé | 2.68 mg/kg | - |
| | Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza | 9.6 mg/l | - |
| | Ujë i ëmbël | 0.0022 mg/l | - |
| | Sediment uji të ëmbël | 1.05 mg/kg | - |
| | Ujë deti | 0.00022 mg/l | - |
| | Sediment uji të kripur | 0.11 mg/kg | - |
| | Impiant i Trajtimit të Ujërave të Zeza | 1 mg/l | - |
| | Dhé | 0.21 mg/kg | - |

8.2 Kontrollat e ekspozimit

Komanda inxhinierike të përshtatshme : Siguroni ajrim të mjaftueshëm. Atje ku është e mundshme, kjo duhet arritur nëpërmjet ajrimit shkarkues vendor dhe nxjerrjes së ajrit nga ambienti. Nëse këto nuk mjaftojnë për t'i mbajtur përqendrimit e partikulateve dhe avujt e tretësve nën OEL (Kufiri i Ekspozimit në Vendin e Punës), duhet përdorur mbrojtje e përshtatshme për rrugët e frymëmarrjes.

Masa të mbrojtjes individuale

Masa higjienike : Pasi të keni punuar me produkte kimike, lajini duart, parakrahët dhe fytyrën mirë e me kujdes, para se të hani, të pini duhan, të përdorni shërbimet higjienike dhe në përfundim të orarit të punës. Për të hequr veshjet që mund të jenë ndotur me material, duhen përdorur teknika të përshtatshme. Rrobat e punës të ndotura nuk duhen nxjerrë jashtë vendit të punës. Lajini rrobat e ndotura para se t'i përdorni përsëri. Sigurohuni që pikat e posaçme për larje sysh dhe dushet e sigurimit janë në afërsi të vendit të punës.

Mbrojtje për sytë/fytyrën : Duhet mbajtur syze mbrojtëse që pajtohen me një normë të miratuar sa herë që një vlerësim i rrezikut e bën të nevojshme për të shmangur ekspozimin ndaj spërklave të lëngshme, mjegullimeve, gazeve ose pluhurave. Nëse ekziston mundësia e kontaktit, duhet përdorur mbrojtja e mëposhtme, përveçse kur vlerësimi tregon si e nevojshme një mbrojtje e shkallës më të lartë: syze mbrojtëse kimike kundër spërklave. I rekomanduar: syze mbrojtëse kundër spërklave kimike dhe/ose mburojë për fytyrën.

Mbrojtje për lëkurën

Mbrojtje për duart : Kur punoni me produkte kimike duhet të mbani gjatë gjithë kohës doreza kemio-rezistente dhe të papërshkueshme, nëse kjo rezulton e nevojshme nga vlerësimi që i bëhet rrezikut. Duke mbajtur parasysh parametrat e specifikuar nga fabrikanti i dorezës, kontrolloni nëse dorezat po i ruajnë ende vetitë e tyre mbrojtëse gjatë përdorimit. Duhet pasur parasysh se kohëzgjatja maksimale e përdorimit të dorezave të çfarëdolloj materiali mund të ndryshojë nga një markë dorezash në tjetrën. Në rast përzjeresh të lëndëve të ndryshme, kohëzgjatja e mbrojtjes që ofrojnë dorezat nuk mund të përafrohet me saktësi. > 8 orë (intervali i depërtimit): I rekomanduar EN 374 polivinil alkool (PVA) Viton® >= 0.7 mm < 1 orë (intervali i depërtimit): Conditionally suitable materials for protective gloves; EN 374: Nitrile rubber - NBR (>= 0.35 mm). Only suitable as splash protection. Only suitable for brief exposure. In the event of contamination, change protective gloves immediately.

Nuk ekziston ndonjë material ose kombinim materialesh universal për dorezat, që të ofrojë rezistencë të pakufizuar ndaj çdo kimikati individual ose përzjerjeje kimikatesh. Kohëzgjatja e mbrojtjes që ofrojnë dorezat duhet të jetë më e madhe sesa jetëgjatësia totale e produktit.

Duhet të ndiqni udhëzimet dhe të dhënat që ofron fabrikanti i dorezave për përdorimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe zëvendësimin.

Dorezat duhen zëvendësuar rregullisht dhe nëse ka ndonjë shenjë dëmtimi në materialin e dorezës.

Gjithnjë sigurohuni që dorezat nuk kanë defekte dhe se po ruhen dhe përdoren siç duhet.

SEKSIONI 8: Kontrollat e ekspozimit/mbrojtja personale

Rendimenti dhe efektshmëria e dorezës mund të reduktohen në rast dëmtimi fizik/kimik dhe mirëmbajtjeje të pamjaftueshme.

Kremrat barrierë mund të ndihmojnë për të mbrojtur zonat e ekspozuara të lëkurës por nuk duhen aplikuar pasi të ketë ndodhur ekspozimi.

- Mbrojtje për trupin** : Pajisjet e mbrojtjes personale për trupin duhen përzgjedhur në bazë të detyrës që duhet kryer dhe rreziqeve përkatëse, si dhe miratuar nga një specialist para se të trajtohet ky produkt. Atje ku ekziston rreziku i ndezjes për shkak të elektricitetit statik, përdorni veshje mbrojtëse anti-statike. Për mbrojtje optimale nga shkarkesat elektrostatische, veshja duhet të përfshijë kominoshe, çizme dhe doreza anti-statike. Referojuni Standardit Europian EN 1149 për të dhëna të mëtejshme për kërkesat në lidhje me materialin dhe dizajnin si dhe për metodat e testimit. I rekomanduar: Kominoshet ose tutat mbrojtëse prej pambuku ose pambuku/sintetike janë normalisht të përshtatshme.
- Mbrojtje tjetër për lëkurën** : Këpucët e përshtatshme dhe masat e mëtejshme mbrojtëse për lëkurën duhet të përzgjidhen sipas detyrës që po kryhet dhe rreziqeve që lidhen me të, si dhe duhen miratuar nga një specialist para se të trajtohet produkti.
